

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 712 Prot.

Tiranë, më 04.07 2016

VENDIM Nr. 70, datë 28.06.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 8 të datës 28.06.2016, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Ndërtim dhe Transferim i HEC-ve "Zaje & Tujan & Xhaferraj & Kollovoz & Novoseje & Meshteken", në rrjedhën e përroit të Rekës dhe Shishtavecit, rrethi Kukës-subjekti "REKA ENERGY" sh.p.k.*, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Ylli Cerova,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Ndërtim dhe Transferim i HEC-ve "Zaje & Tujan & Xhaferraj & Kollovoz & Novoseje & Meshteken", në rrjedhën e përroit të Rekës dhe Shishtavecit, rrethi Kukës-subjekti "REKA ENERGY" sh.p.k.*, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Ylli Cerova.
2. Shoqëria "REKA ENERGY" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të zbatimit të *"Ndërtim dhe Transferim i HEC-ve "Zaje & Tujan & Xhaferraj & Kollovoz & Novoseje & Meshteken", në rrjedhën e përroit të Rekës dhe Shishtavecit, rrethi Kukës*, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

